



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.,

Data ____ . ____ . 2024

PROCESVERBAL-Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURES: "Krijimi i Sistemit Elektronik për Masat
Administrative".**

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 48800000-6

Vlera e Fondit Limit: 14,875,000 (katërbëdhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë lekë pa TVSH).

Afati kohor për dorëzimin e ofertave: 15 (pesëmbëdhjetë ditë) sipas Nenit 42, pika 5 e Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", ku përcaktohet se: "*Për procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar, afati për pranimin e ofertave është jo më pak se 20 ditë nga shpallja e njoftimit të kontratës dhe, në rast se ofertat paraqiten me mjete elektronike, ky afat mund të shkurtohet me 5 ditë.*"

Procedura e këtij prokurimi është: Procedure e Hapur / Kontratë Shërbimi

Kohëzgjatja në muaj: Periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) jave.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të të prokurimit prok publik", autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Adresa: Rruga "Murat Toptani" 1001, Ndërtesa Nr.12, kati 2, Tiranë, Shqipëri
Tel: 04274774. E-mail: konsumatori@tirana.al

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PERZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen është e parashikuar se: *1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;

Argumentimi: Kjo shtojcë është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipercituar.

c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik“, ne te cilen është e parashikuar se: *Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e*

procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

d. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", dhe nenin 26 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në të cilën është e përcaktuar se: "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla."

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe shtojcës 9 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, dhe 2023** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 40, neni 43, pika 2, germa b) të V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,

V.K.M Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës objekt prokurimi, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar". Kjo procedurë është mbi kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit, të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raporte negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Kapaciteti pozitiv financiar i operatorit i dokumentuar me bilance i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Pasqyrat financiare me bilanc pozitiv paraqesin vërtetësi dhe besueshmëri në pozicionin financiar të operatorit ekonomik.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë totale jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të

plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë si dëshmi vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40% të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues në funksion të garantimit të përmbushjes së menaxhimit të cilësisë të shërbimeve që kategorizon kjo procedurë, duhet të dëshmojë se zotëron certifikimet:

- ISO 20000-1:2018 për Menaxhimin e Shërbimieve TI;
- BS PAS 99: 2012 "Sistemi i menaxhimit të integruar"
- ISO 27001:2022 për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit;
- ISO 9001:2015 për Menaxhimin e Cilësisë;

ose versionet e përditësuara, lëshuar nga institucionet e akredituara për këtë qëllim ose ekuivalente me to

Certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme deri në përfundimin e kontratës.

Argumentimi: Kriteri ne lidhje me standardet e mesiperme është vendosur në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Me konkretisht:

Zoterimi i certifikimit per standardin **ISO 20000-1:2018 “Menaxhimi i Shërbimieve TI”** shërben si nje garanci per Autoritetin Kontraktor se operatori ekonomik ka të zbatuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit mund te planifikoje, implementoje, operoje, monitoroje dhe te kontrolloje shërbimet e ofruara dhe cilësinë e tyre sic jane ne kete rast shërbimet e instalimit dhe konfigurimit te sistemit qe kerkohet te ndertoht, ne infrastrukturen ekzistuese te institucionit.

Certifikimi per standardin **BS PAS 99:2012 “Sistemi i menaxhimit të Integruar”** kerkohet duke qene se objekt i projektit eshte instalimi i sistemit qe do ndertoht ne infrastrukturen ekzistuese te institucionit, duke patur ne vemendje te vecante dhe sigurine e te dhenave sensitive dhe konfidenciale qe mund te jene te hostuara ne kete infrastrukture. Ky standard kerkohet si prove qe operatori ekonomik do te realizoje shërbimet qe kerkohen sipas standardeve me te mira bashkekohore dhe zoteron aftësite e duhura optimizuese për të gjitha sistemet e menaxhimit me të cilat punon në funksion të ofrimit të shërbimeve sa më efikase dhe profesionale.

Certifikimi ne lidhje me standardin **ISO 27001:2022 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit”** është i nevojshëm për te siguruar qe operatori ekonomik ka aftësite dhe resurset e nevojshme per krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi per te menaxhuar sigurine e informacionit, duke perfshire dhe analizimin, vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshatura sipas nevojave te institucionit, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurtë dhe të mos çënohet siguria e sistemeve të tjera qe ,und te jene te hostuara ne te njejten infrastrukture fizike..

Certifikimi per standardin **“ISO 9001:2015 Menaxhimi i Cilesise”** shërben si deshmi per Autoritetin Kontraktor se operatori ekonomik ka aftësite dhe resurset e duhura per

te siguruar shërbime që përmbushin pritshmërit e tij.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar për furnizimin e produkteve hardëare që ofertojnë. Autorizimi i prodhuesit duhet të përmbajë: emër prodhuesi dhe të dhëna mbi kompaninë. Në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributor, duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (si kontratë, certifikatë, deklaratë etj).

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e Autorizimit nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar për pajisjet hardëare që do ofertojnë, garanton se Operatori Ekonomik është në gjëndje të ofrojë produktet drejtperdrejt nga prodhuesi, sipas specifikimeve teknike të kërkuara për këtë procedurë prokurimi.

Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë që zotëron partneritet të stabilizuar dhe autorizimin e nevojshëm për të lëvruar produktet e kërkuara në këtë prokurim, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të jetë i sigurtë që nuk ka ndonjë risk të mundshëm që mund të vijë si pasojë e mospërmbushjes së kontratës nga operatori për shkaqe që lidhen me marrëdhënien e biznesit midis operatorit dhe prodhuesit të pajisjeve apo softuereve perkates, duke siguruar që kanali i furnizimit është i njohur dhe i autorizuar nga prodhuesi. Në këtë mënyrë synohet të minimizohet deshtimi për mos realizim të këtyre komponenteve të projektit.

Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me nenin 77 pika 1 Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjëndjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Neni 40 pika 3 I VKM nr 285 datë 19.05.2021 parashikon se *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”*

Sa më lartë dhe në përputhje të plotë me dispozitat ligjore Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm për përmbushjen e kriterit 2.3.3.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin ose personelin teknik si më poshtë :

- 1) 1 (një) punonjes si drejtues projekti, te diplomuar në shkencë kompjuterike ose elektronike, qe zoteron certifikatën PMP (lëshuar nga Project Management Institute) ose ekuivalent, te njohur zyrtarisht per kete qellim.
- 2) Te pakten 1 (një) punonjes te certifikuar per sigurine ne aspektin e te dhenave.
- 3) Te pakten 1 (nje) analist biznesi te certifikuar ne analizimin e kerkesave dhe proceseve te punes per sistemin qe do ndertoht.
- 4) Te pakten 2 (dy) zhvillues software, të certifikuar për implementim zgjidhjesh softwerike se ofruar ose te teknologjive nga te cilat perbehet zgjidhja softwerike.
- 5) Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per zhvillimin ose administrimin e bazes se te dhenave qe perdor zgjidhja softëerike e ofruar.
- 6) Te pakten 1 (nje) person të certifikuar ne implementimin e sherbimeve ëeb duke perdorurt protokollet SOAP ose REST ose ekuivalent.

***Shënim, ky kriter duhet të provohet me Listëpagesat sipas formularit E -Sig 025/a të 6 gjashtë muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës dhe me certifikatat përkatëse të kërkuara nga AK.**

Argumentim: pika 1) Për të siguruar koordinim te sukseshem te aktiviteteteve te projektit si dhe mbarëvajtjen e kontratës per te permbushur cdo detyre, ritshmeri si dhe afatet me cilësi dhe ne perputhje me standartet dhe bazuar në metodologji botërore, OE duhet të ketë në dispozicion të kontratës një një punonjës të certifikuar ne fushen e menaxhimit te projekteve (PMP ose ekuivalente).Autoriteti Kontraktor kerkon qe projekti te drejtohet nga nje person i kualifikuar qe te siguroje realizimin e objektivave dhe te gjithë detyrat e kerkuara brenda afateve, me cilesi dhe ne perputhje me specifikimet perkatese. Nje standard i tillë i mirenjohur, sherben si nje garanci per te deshmuar aftesite e nevojshme per te siguruar mbarevajtjen e kontrates ne drejtim te manaxhimit sa me efektiv të procesve dhe aktiviteteteve të parashikuara.

Argumentim: pika 2) Kerkohet nje punonjes qe te jete i certifikuar ne aspektin e sigurise per te dhena duke qene se sistemi do te manaxhoje te dhena konfidenciale dhe sensitive si dhe do te instalohet ne nje infrastrukture ekzistuese duke ngritur dhe konfiguruar ambjentin perkates virtaul dhe si pasoje duhet siguruar qe te mos kete rrjedhje te paautorizuar te tyre.

Argumentim: pika 3) Punonjesi i kualifikuar si analist biznesi kerkohet me qellim qe te ofroje mbledhje dhe analize te sakte te te dhenave dhe kerkesave mbi rrjedhen e punes se perdoruesve sipas sektoreve te perfshire. Nje analize e sakte sjell dhe nje dizenjim te sakte te zgjidhjes softuerike qe kerkohet te implementohet.

Argumentim: pika 4) Nepermjet permbushjes se ketij kriteri, Autoriteti Kontraktor sigurohet se operatori ekonomik disponon stafin e nevojshem te kualifikuar per te ndertuar nje softuer sipas nevojave te institucionit, duke realizuar te gjitha kerkesat ne menyre cilesore dhe efektive por dhe te ofrojne nje produkt qe te jete sa me i lehte ne perdorim nga perdoruesit fundore.

Argumentim: pika 5) AK kerkon qe ne perberje te ekipit te operatorit ekonomik qe do zbatoje projektin te jete dhe 1 punonjes i kualifikaur per zhvillimin dhe administrimin e bazes se te dhenave per te garantuar dizenjimin, ndertimin dhe zbatimin e bazes se te dhenave per softuerin e ri te kerkuar, per te garantuar qe te dhenat te mund te ruhen ne menyre eficientesipas stadarve me te mira dhe qe te plotesoje me se miri nevojat e perdoruesve.

Argumentim: pika 6) Duke qënë se dhe në dokumentin e Termave të Referencës është kërkuar që sistemi i ri që do ndërtohet duhet të jetë në gjëndje të integrohet dhe me sisteme te tjera ekzistuese apo ne te ardhmen, është e nevojshme qe integrimi te tilla te realizohen nga nje profesionist i cili te mundesoje keto funksionalitete te sistemit qe te jene te ndertuara sakte dhe te jene funksionale ne momentin qe do nevojiten.

Personeli i mësipërm duhet të ketë aktualisht një marrëdhënie pune me ofertuesin, pra të jetë në listëpagesën e muajit të fundit.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor.

Kriteret e veçanta për kualifikim të përshkruara më lart, janë hartuar nga Grupi i Punës në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar dhe sipas funksionalitet që do të ketë ky shërbim për Autoritetin Kontraktor.

Gjithashtu në nenin 41 pika 4 Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet se: *Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Neni 40 pika 3 e VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 parashikon se “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”

Sa më lartë dhe në përputhje të plotë me dispozitat ligjore Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm për përmbushjen e kriterit 2.3.3

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë jep siguri dhe besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën brenda afatit dhe me cilësi. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar dhe me kohë të plotë, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, gjithashtu, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë listë pagesat e shoqëruara me

formularët e deklarimit të pagesave shoqërore dhe shëndetësore me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kriteret e mësipërme janë dhe në përputhje me parashikimet e nenit 41 pika 4 dhe pika 6 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet se: “a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*”

“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”

Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

Shënim: Operatori ekonomik i kualifikuar i pare duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionim provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për medikamente dhe materialeve mjekësore veterinarë. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti. Sa më sipër, specifikimet teknike, janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt "Krijimi i Sistemit elektronik për masat administrative", Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Njësia e Prokurimit:

- Ana Cici - Personi Përgjegjës
- Irdi Taipi- Anëtar
- Liridona Isufaj- Anëtar